



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

Paraja dhe Bankat EKB0023

Data e aprovimit:	Data
Verzioni:	Verzion
ECTS:	9
Bartësi i lëndës:	Enisa Serhati
Email:	enisa.serhati@riinvest.net
Telefoni:	

Hyrje:

Kjo lëndë synon t'u ofrojë studentëve njohuri në fushën e parasë dhe bankave përmes sqarimit të një serë konceptesh ekonomike, të cilat u krijojnë atyre mundësinë për ta konceptuar sistemin financiar. Njohuritë fillestare rreth sistemit financiar studentët i kanë marrë në lëndët si "Mikroekonomia 1", "Makroekonomia 1", dhe "Menaxhimi i Bankave dhe Operacionet Bankare", ndërsa ky kurs synon të ju japë njohuri më të thelluara në kuptimin e sjelljes së bankave dhe të adresojë disa nga trendët kryesore në industrinë bankare në vend dhe në shkallë ndërkombëtare në kohën më të re – gjithnjë duke përdorur metodologji për analizë ekonomike. Lënda është dizajnuar të analizojë ndikimin apo efektin e parasë dhe bankave në disa variabla kryesore ekonomike, siç janë normat e interesit, inflacioni, dhe industria financiare. Po ashtu, lënda trajton rolin e bankave komerciale dhe bankës qendrore në procesin e implementimit dhe zbatimit të politikës monetare.

Qëllimet

Qëllimi i lëndës "Paraja dhe Bankat" është njohja e studentëve me rolin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm që bankat dhe institucionet e tjera financiare si ndërmjetës financiar, luajnë në efikasitetin dhe ekonomisë së një vendi. Qëllim i kësaj lënde është edhe njohja e studentëve me konceptin e parasë, historinë e parasë, si dhe ndikimin që ka kjo e fundit në indikatorët makroekonomik në ekonominë e një vendi. Gjithashtu, qëllim i kësaj lënde është edhe njohja e studentëve me teoritë dhe praktikën e përdorimit të teknikave bankare, mënyrat e funksionimit të Bankës Qendrore dhe bankave të nivelit të dytë, si dhe me veprimtaritë kreditore të tyre.

Rezultatet e pritura të lëndës

- Të kuptojë sjelljet e bankave
- Të kuptojë sjelljet e institucioneve financiare në përgjithësi
- Të kuptojë ndikimin e institucioneve financiare në ekonomi
- Të pajiset me njohuri lidhur për tregjet financiare

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Sistemi financiar, paraja, bankat dhe tregjet financiare	Ligjerata dhe Ushtrime
2	Analiza e sistemit financiar	Ligjerata dhe Ushtrime
3	Paraja	Ligjerata dhe Ushtrime
4	Normat e Interesit dhe sjellja e normave te interesit	Ligjerata dhe Ushtrime
5	Normat e interesit dhe risku	Ligjerata dhe Ushtrime
6	Tregu Valutor	Ligjerata dhe Ushtrime
7	Veprimtaria Bankare	Ligjerata dhe Testi I
8	Fitimi dhe performanca e veprimtarisë bankare	Ligjerata dhe Ushtrime
9	Mbikqyrja Bankare	Ligjerata dhe Ushtrime
10	Institucionet jo-bankare	Ligjerata dhe Ushtrime
11	Banka qendrore	Ligjerata dhe Ushtrime
12	Krijimi i parasë	Ligjerata dhe Ushtrime
13	Oferta dhe Kërkesa për para	Ligjerata dhe Ushtrime
14	Ekulibri dhe politika monetare	Ligjerata dhe Ushtrime
15	Testi II (Provimi final)	Mbajtja e testit

Informata shitesë 1:

Pjesëmarrja ne ligjërata dhe ushtrime është shume e rëndësishme. Studentët inkurajohen që të jenë të rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Ata inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave. Profesorët dhe asistentët do të jenë në dispozicion për sqarime shitesë dhe konsultime. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë literaturën që u është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët gjithashtu do të jenë të obliguar të marrin pjesë në teste që do të organizohen gjatë semestrit. Ata do te mbështeten gjate gjithë kohës per te përvetësuar programin. Studentet inkurajohen te përcjellin diskutimet ne media dhe te pyesin lidhur me ecuritë dhe problemet financiare ndërkombëtare dhe te hapin diskutime lidhur me to.

Vlerësimi:

Nr.	Lloji Vleresimit	Perqindja	Pershkrimi
1	Pjesëmarrja	10	Vijushmëria dhe angazhimi në ligjerata dhe ushtrime
2	Prezentim	20	Prezente ne klasë
3	Kolokvium	35	Testi i parë do të realizohet pas javës së gjashtë dhe do të përfshijë materialin e mbuluar deri atëherë
4	Provimi Final	35	Testi i dytë do të realizohet pas javës së pesëmbëdhjetë; në këtë test përfshihen edhe kapitujt e pjesës së parë
5	Detyra	0	

Kushtet e përsëritjes:

Sipas rregullores së studentëve të Kolegjit Riinvest, studenti ka të drejtë deri në tri herë të tentojë me kaluar lëndën. Nëse studenti nuk arrin që ta kalojë lëndën në mundësinë e parë, atëherë vlerësimet e mëhershme (vijueshmëria, vlerësimet e testeve dhe eseve) gjatë ligjëratave i ruhen studentit deri në afatin e fundit që e ka për ta dhënë këtë lëndë. Nëse studenti nuk arrin që ta kalojë lëndën deri në mundësinë e tretë që është në afatin e Shtatorit, atëherë studenti duhet ta përsëris komplet lëndën edhe një herë.

Burimet:

- 1. "Paraja dhe Bankat" - Dr.Bujar Leskaj dhe Adriatik Kotorri, 2011 2. "Paraja dhe institucionet financiare" - Dr. Drini Salko dhe Dr. Orfea Dhuci, 2013

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	45	
Ushtrime:	30	
L+U:	75	
Seminar/praktike.:	0	
Studim i vazhdushem:	115	
Pregaditja e Provimit:	30	
Pjesemarrja ne teste:	2	
Pjesemarrja ne provimin final:	3	
Me profesorin dhe asistentin:	0	
Total Ore:	225	
ECTS:	9	